



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI QENDROR I ZGJEDHJEVE

Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve

Data:15.5.2023

Nr: 75

Ora: 20:30

U R D H Ë R

PËR

VAZHDIMIN NË MËNYRË TË PANDËRPRERË DHE ORGANIZIMIN E PROCESIT TË NUMËRIMIT TË VOTAVE, NË KZAZ-TË NR. 35 E NR. 38, BASHKIA TIRANË DHE KZAZ-NË NR. 42, BASHKIA KAVAJË, PËR ZGJEDHJET PËR ORGANET E QEVERISJES VENDORE TË DATËS 14 MAJ 2023

Në mbështetje të nenit 19, pikat 1, shkronja “b”, dhe 2, të nenit 116/1 e vijues të Kodit Zgjedhor, të nenit 26, të Kodit të Procedurave Administrative dhe të vendimit nr. 23, datë 24.4.2023, “Për organizimin e punës në Vendin e Numërimit të Votave, radhën e veprimeve gjatë dorëzimit të materialeve zgjedhore, numërimit të votave dhe nxjerrjes së rezultatit të zgjedhjeve për zonën e administrimit zgjedhor, për zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore”,

URDHËROJ:

1. KZAZ-të nr. 35 dhe nr. 38, bashkia Tiranë, dhe KZAZ-ja nr. 42, bashkia Kavajë, të vazhdojnë pandërprerë procesin e numërimit të votave për kandidatët për kryetar të bashkisë.
2. Për procesin e numërimit të votave për këshillin e bashkisë, në rast të ndërprerjes, këto KZAZ të marrin masa organizative për ta rifilluar atë jo më vonë se ora 8:00, e datës 16 Maj 2023, dhe ta përfundojnë jo më vonë se ora 16.00 e po kësaj date.
3. Ngarkohen KZAZ-të nr. 35 dhe nr. 38, bashkia Tiranë, dhe KZAZ-ja nr. 42, bashkia Kavajë për zbatimin e këtij urdhri.

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë.

Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve

Ilirjan CELIBASHI

Data:15.5.2023 Nr.75
Ora:20:30



“Për vazhdimin në mënyrë të pandërprerë dhe organizimin e procesit të numërimit të votave, në KZAZ-të nr. 35 e nr. 38, bashkia Tiranë dhe KZAZ-në nr. 42, bashkia Kavajë, për zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore të datës 14 Maj 2023”

Data: 2023 Nr.
Ora: 12:00



“Për disiplinimin dhe vazhdimin në mënyrë të pandërprerë të procesit të numërimit të të gjitha kutive të votimit të pranuar të rregullta nga KZAZ-të”